

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.P., nga Prizreni, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par 1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.992/2017, të dt.30.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 31.07.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të akuzuarit A.P., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.992/2017, të dt.30.03.2018 , **vërtetohet.**

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.992/2017, të dt.30.03.2018, është shpallur fajtor i akuzuari A.P., nga Prizreni për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par 1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është obliguar i akuzuari që ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën i njëjti në kuptim të nenit 46 par 3 të KPK, të zëvendësohet në dënimin me burgim në kohëzgjatje prej (10) dhjetë ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 (njëzetë) €

Te dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, janë udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 40.88€ në emër të ekspertizës së komunikacionit, në emër të ekspertizës mjekësore shumën prej 20€, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 30 € në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë i akuzuari A.P. për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i butë.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/II.nr.720/2018, të datës 16.07.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar, ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e akuzuari A.P., nuk është e bazuar.

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe shkeljet e ligjit penal, mirëpo me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, të akuzuarit i ka shqiptuar dënim të ashpër, sikurse theksohet në dispozitiv të aktgjykimin, duke mos i vlerësuar rrethanat lehtësuese në masë të duhur, sikurse janë, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, së është penduar për veprën, se është hera e parë që ka ra në kundërshtim me ligjin, se dëmi i shkaktuar nga kryerja e veprës penale ka qenë i vlerës së vogël, andaj konsiderojmë se dënimi i shqiptuar është shumë i ashpër, dhe se edhe me ndonjë dënim më të butë do të mund të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit i paraparë me ligj.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, ashtu që kolegji pas vlerësimit të aktgjykimin, vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barrë, se i akuzuari ka kërkuar falje publike për veprën e kryer penale, se ka patur qëndrim korrekt në gjykatë dhe është penduar për veprën penale, se ka ç'faqur gatishmëri të bashkëpunojë me gjykatë, ndërsa si rrethana rënduese ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të kryer, andaj në prani të këtyre rrethanave, gjykata e shkallës së parë ka aplikuar dispozitat ligjore nga neni 74, 75 dhe 76 të KPK, përkitazi me rregullat e përgjithshme për zbutjen apo ashpërsimin e dënimeve, zbutjen e dënimeve, si dhe kufijtë e zbutjes së dënimeve, e duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, sikurse pretendon i akuzuari në ankesën e ushtruar, kolegji i kësaj

gjykatë, është i bindur se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës shkallës parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.714/2018, të datës 31.07.2018

Bashkëpunëtori profesional
Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Biljana Rexhiq